

Vendim nr. 70 datë 15.10.2024

(V-70/24)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 15.10.2024 mori në shqyrtim në seancë mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **DRITAN NUZI**, përfaqësuar nga avokat Muhamet Hoxha, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Arqile Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 46, datë 03.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. 1766, datë 03.07.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-1445, datë 19.09.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 15, 27, 32, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 e 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 06.01.2014 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (*Prokuroria Dibër*) ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal (*KP*). Në vijim të hetimeve paraprake të këtij procedimi penal, në datën 01.09.2015, në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, Prokuroria Dibër ka regjistruar emrat e kërkuesit Dritan Nuzi dhe të shtetasit I.K., si të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 248 e 25 të KP-së. Fakti penal lidhej me procedurën administrative të dhënies së lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit të një shtese anësore në një pallat ekzistues 3-katësh në qytetin e Peshkopisë, në favor të shtetasve Sh.K. dhe D.M., të miratuara në datën 29.09.2006 nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Peshkopi (*KRRT, Peshkopi*), në zbatim të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar (*ligji i urbanistikës*). Në vijim, kërkuesi dhe shtetasi I.K. janë akuzuar për këtë vepër penale dhe janë dërguar për gjykim.

2. Gjykimi i çështjes është zhvilluar përmes ritit të gjyimit të shkurtuar, pasi gjykata ka vlerësuar se ajo mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, shkak për të cilin aktet e hetimit paraprak janë bërë pjesë e fashikullit të gjyimit. Në përfundim të gjyimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 46, datë 03.03.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, duke e dënuar atë me 1 vit burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) kërkuesi është dënuar përfundimisht me 8 muaj burgim dhe ndaj tij është caktuar edhe dënimi plotësues i heqjes së të drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vjetësh. Për të bashkëpandehurin I.K., gjykata ka vendosur deklarinimin e tij të pafajshëm për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, për të cilën akuzohej se e kishte kryer në bashkëpunim me kërkuesin. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim kërkuesi, ashtu edhe Prokuroria Dibër, për sa i përket deklarinimit të pafajshëm të bashkëpandehurit I.K.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1766, datë 03.07.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket kërkuesit, por duke zëvendësuar dënimin me burgim ndaj tij me atë të punës në interes publik në masën e 40 orëve, në zbatim të nenit 63 të KP-së. Për ankimin e Prokurorisë Dibër, gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e tij, për shkak se nuk plotësonte kriteret ligjore të pranueshmërisë. Kërkuesi e ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit në Gjykatën e Lartë, për të cilin Kolegji Penal i

asaj gjykate, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1445, datë 19.09.2023, ka vendosur mospranimin e tij.

4. Në datën 19.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 12.03.2024. Në datën 09.05.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

5.1. *Parimit të prezumimit të pafajësisë* në aspektin e të provuarit të fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, pasi prova e vetme për dënimin e tij është zbardhja nga ai e lejes së ndërtimit në datën 24.03.2010, në cilësinë e sekretarit të KRRT-së, Peshkopi, provë e cila është keqinterpretuar nga gjykatat, duke shtrembëruar në mënyrë flagrante faktin e punësimit të tij në detyrën e përgjegjës të seksionit të urbanistikës në kohën e miratimit të lejes së ndërtimit, pra në datën 29.09.2006, kohë kur ai ka qenë student, ndërkohë që është emëruar në detyrë në datën 18.03.2009, referuar edhe aktit të emërimit të administruar nga organi i akuzës gjatë hetimeve paraprake. Përcaktimi i fakteve nga gjykatat është dukshëm i gabuar, ndaj zbatimi i ligjit duke e dënuar atë është arbitrar dhe haptazi i paarsyeshëm. Nga ana tjetër, zbardhja e lejes së ndërtimit nga kërkuesi është në përputhje me ligjin e urbanistikës dhe kjo është bërë pasi ai ka administruar autorizimin për pagesën e lejes së ndërtimit të lëshuar në kohën e miratimit dhe aktin përkatës (veprimin e arkës) për pagesën e saj. Mosveprimi për lëshimin e lejes do të ishte në shkelje të ligjit.

5.2. *Parimit të barazisë përpara ligjit në gjykim*, pasi gjykatat, në të njëjtin proces, kanë deklaruar të pafajshëm të bashkëpandehurin I.K., megjithëse edhe ai, njëlloj si kërkuesi, ka nënshkruar si kryetar i KRRT-së, Peshkopi zbardhjen e lejes së ndërtimit të miratuar në datën 29.09.2006.

5.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit ka renditur një sërë shkeljesh si të kryera nga kërkuesi, por nuk ka analizuar dhe kthyer përgjigje pretendimit të tij në ankim se është deklaruar fajtor për shpërdorim

detyre, megjithëse nuk ka qenë në detyrën e përgjegjësit të seksionit të urbanistikës në kohën e miratimit të lejes së ndërtimit, e cila referohet të jetë bërë në shkelje të ligjit të urbanistikës. Mungesa e argumenteve kundërshtuese për pretendimet e kërkuesit në ankim dhe mospasqyrimi i debatit gjyqësor, janë tregues të mungesës së arsytimit të vendimit nga gjykata e apelit. Edhe Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk i ka kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuesit. Konstatimet e saj se gjykatat e faktit kanë arsyetuar përgjegjësinë e tij penale përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, pasi ai ka nënshkruar lejen e ndërtimit të datës 29.09.2006, janë haptazi të gabuara, për sa kohë që ato gjykata kanë përmbysur dukshëm faktet e çështjes.

6. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, ka prapësuar:

- 6.1. Pretendimet e kërkuesit që kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe me interpretimin e ligjit, të cilat nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.
- 6.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* është haptazi i pabazuar, pasi gjykatat kanë pranuar si të provuar tejk çdo dyshimi të arsyeshëm kryerjen nga ai të veprës penale për të cilën është akuzuar. Kërkesat e shtetasve Sh.K. dhe D.M. për leje sheshi dhe leje ndërtimi, të miratuara nga KRRT-ja, Peshkopi, në datën 29.09.2006, janë shqyrtuar dhe i kanë kaluar për miratim asaj nga kërkuesi, në cilësinë e përgjegjësit të seksionit të urbanistikës, megjithëse nuk ka pasur një studim urbanistik të miratuar dhe pa qenë e rregulluar marrëdhënia juridike e pronësisë së truallit, në kundërshtim me ligjin e urbanistikës.
- 6.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit në gjykim* është i pabazuar, pasi ai është trajtuar nga prokuroria dhe gjykatat në mënyrë të barabartë me të akuzuarit e tjerë dhe, si në fazën e hetimit, ashtu edhe të gjykimit, i është nënshtruar së njëjtës procedurë me ta. Gjykata e shkallës së parë ka argumentuar në mënyrë të detajuar pafajësinë e shtetasit I.K., për sa kohë nuk është arritur të provohet bashkëpunimi i tij me kërkuesin. Ky vendim, për këtë shtetas, ka marrë formë të prerë, pasi gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit të prokurorit.
- 6.4. Edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar. Vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë përmbajnë, në pjesën hyrëse, të dhënat e të akuzuarit, akuzën, disponimet e gjykatave më të ulëta dhe shkaqet e ankimit, ndërsa në pjesën arsyetuese, vlerësimin dhe argumentet që

i kanë çuar ato në qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Vendimet nuk janë alogjike dhe as kanë kundërthënie, duke plotësuar kërkesat në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë, kjo gjykatë, në përputhje me kompetencat e saj, pas vlerësimit paraprak të rekursit të kërkuarit, ka çmuar se në të nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së apo se ato janë haptazi të pabazuara, ndërkohë që për pretendimet në lidhje me provat dalin jashtë funksionit të saj ekskluzivisht ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në këtë këndvështrim, kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuari i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit

kushtetues individual, për vendimet e Gjykatës së Lartë data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata vëren se sipas shkresës nr. 90/1 prot., datë 12.01.2024 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, të vënë në dispozicion nga kërkuesi, vendimi i kundërshtuar i asaj gjykate është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 19.10.2023, datë në të cilën palët mund ta dispononin atë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është dërguar në Gjykatë, sipas shënimit të shërbimit postar, në datën 19.02.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë, të parimit të barazisë përpara ligjit në gjykim dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pretendime të cilat kanë natyrë kushtetuese dhe, si të tilla, përfshihen në juridiksionin kushtetues. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e argumenteve, mbi të cilat kërkuesi ka mbështetur këto pretendime, çmon që të analizojë në vijim bazueshmërinë e tyre në themel në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

13. Kërkuesi ka pretenduar se është dënuar nga gjykatat si rrjedhojë e përcaktimit dukshëm të gabuar të fakteve dhe në zbatim arbitrar dhe haptazi të paarsyeshëm të ligjit. Sipas tij, në kohën e realizimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesave të shtetasve Sh.K. dhe D.M. për leje sheshi dhe leje ndërtimi, të miratuara nga KRRT-ja, Peshkopi, në datën 29.09.2006, ai ka qenë student, ndërsa është emëruar në atë detyrë në datën 18.03.2009 referuar edhe aktit të emërimit të administruar nga organi i akuzës gjatë hetimeve paraprake. Prova e vetme për dënimin e tij, sipas kërkuesit, është zbardhja nga ai i lejes së ndërtimit në datën 24.03.2010, në cilësinë e sekretarit të KRRT-së, Peshkopi, provë e cila është keqinterpretuar nga gjykatat, duke shtrembëruar në mënyrë flagrante faktin e punësimit të tij në detyrën e përgjegjës të seksionit të urbanistikës në kohën e miratimit të lejes së ndërtimit. Po sipas tij, gjykatat kanë deklaruar të pafajshëm të bashkëpandehurin I.K., megjithëse edhe ai, njëlloj si kërkuesi, ka nënshkruar si kryetar i KRRT-së, Peshkopi zbardhjen e lejes së ndërtimit të miratuar në datën

29.09.2006. Gjithashtu, sipas kërkuesit, gjykata e apelit nuk ka analizuar dhe kthyer përgjigje pretendimit se është deklaruar fajtor për shpërdorim detyre, megjithëse nuk ka qenë në detyrën e përgjegjës të seksionit të urbanistikës në kohën e miratimit të lejes së ndërtimit. Edhe Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, vijon kërkuesi, nuk i ka kthyer përgjigje pretendimeve të tij, ndërkohë që konstatimet e asaj gjykate se gjykatat e faktit kanë arsyetuar përgjegjësinë penale të tij sipas standardit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, janë haptazi të gabuara, për sa kohë që ato gjykata kanë përmbysur dukshëm faktet e çështjes.

14. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara dhe gjykatat kanë provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerjen nga ai të veprës penale për të cilën është akuzuar. Sipas tij, kërkesat e shtetasve Sh.K. dhe D.M. për leje sheshi dhe leje ndërtimi, të miratuara nga KRRT-ja, Peshkopi, në datën 29.09.2006, janë shqyrtuar dhe i kanë kaluar asaj për miratim nga kërkuesi, në cilësinë e përgjegjës të seksionit të urbanistikës, megjithëse nuk ka pasur një studim urbanistik të miratuar dhe pa qenë e rregulluar marrëdhënia juridike e pronësisë së truallit, në kundërshtim me ligjin e urbanistikës. Gjykata e shkallës së parë, sipas subjektit të interesuar, ka argumentuar në mënyrë të detajuar pafajësinë e shtetasit I.K., ndërsa nuk është arritur të provohet bashkëpunimi i tij me kërkuesin. Ky vendim, për këtë shtetas, ka marrë formë të prerë, pasi gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit të prokurorit. Po sipas subjektit të interesuar, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, vendimi i gjykatës së apelit dhe ai i Gjykatës së Lartë plotësojnë standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

15. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kushtetues ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 4 të KPP-së, i cili përcakton, gjithashtu, se gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Jurisprudenca kushtetuese e ka zbërthyer parimin e prezumimit të pafajësisë në drejtim të elementeve përbërës të tij. Në kuptim të tij, gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet; barra e provës i takon palës akuzuese; gjykatat duhet të mbështesin vendimet në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza; gjykatat janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*); deklarimi i fajësisë së të pandehurit duhet të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim; asnjë dënim apo masë që barazohet me të nuk mund të

jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Edhe sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), në kuadër të garantimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, të garantuar nga neni 6, pika 2, i KEDNJ-së, gjykatat penale kanë detyrimin të përcaktojnë ato fakte të çështjes që kanë rëndësi për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit sa më me kujdes dhe saktësi që është e mundur dhe ato nuk mund të paraqesin faktet e përcaktuara thjesht si pretendime ose dyshime. Sipas saj, veprimet e përshkruara si kriminale duhet të bien brenda fushëveprimit të dispozitës penale të zbatuar, ndaj interpretimi arbitrar dhe i paparashikueshëm i ligjit në mungesë të një vlerësimi të rregullt të përgjegjësisë penale individuale ose përcaktimit të *corpus delicti*, e bën rezultatin e gjykimit haptazi të paarsyeshëm (*shih Navalnyy dhe Ofitserov kundër Ruisë, datë 23.02.2016, §§ 99, 115*).

17. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e

gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me elementet e vendimit gjyqësor, ligji procedural penal përcakton se ai duhet të përmbajë, ndër të tjera, parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta (neni 383 i KPP-së).

20. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit ka të bëjë, në thelb, me faktin se gjykatat e zakonshme e kanë deklaruar atë fajtor për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, duke mos përcaktuar në mënyrë të saktë faktet e çështjes, sikundër ato rezultojnë nga provat e administruara në gjykim, fakte të cilat, nga ana tjetër, kanë shërbyer si bazë për vlerësimin nga ato të përgjegjësisë së tij penale. Sipas kërkuesit, gjykatat e zakonshme nuk kanë përcaktuar kohën kur ai ka ushtruar detyrën e përgjegjës të seksionit të urbanistikës, duke mos vlerësuar për këtë aktin përkatës të emërimit të administruar si provë në gjykim, sikundër nuk i kanë dhënë përgjigje as pretendimit të tij se nuk ka qenë në këtë detyrë në kohën kur ka ndodhur fakti penal i atribuar, çka sipas kërkuesit, e shkarkonte atë nga përgjegjësia penale. Për rrjedhojë, për t’i dhënë përgjigje këtij pretendimi të kërkuesit, Gjykata vlerëson të analizojë nëse arsyetimi i gjykatave të zakonshme përmban gabime faktike ose ligjore, të cilat nuk janë objektivist të justifikueshme dhe të arsyeshme dhe që shkojnë përtej vlerësimit të rregullt të përgjegjësisë penale individuale të kërkuesit. Me fjalë të tjera, gjykata do të verifikojë nëse ato kanë përcaktuar faktet e çështjes me rëndësi për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të kërkuesit përmes vlerësimit të provave të administruara në gjykim dhe, mbi këtë bazë, nëse zbatimi nga ato i ligjit ka qenë arbitrar në dëm të kërkuesit, duke e bërë rezultatin e gjykimit haptazi të paarsyeshëm.

21. Nën këtë optikë, Gjykata konstaton se në aktin e njoftimit të akuzës dhe në kërkesën për gjykim, fakti penal i atribuar kërkuesit lidhet me veprimet e kryera prej tij në detyrën e përgjegjës të seksionit të urbanistikës të Bashkisë Peshkopi, për sa u përket procedurave të ndjekura për dhënien e lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit në favor të shtetasve Sh.K. dhe D.M., të miratuara nga KRRT-ja, Peshkopi, në datën 29.09.2006. Formularët përkatës të këtyre lejeve janë lëshuar respektivisht në datat 24.03.2009 dhe 24.03.2010, dhe ato përmbajnë, krahas nënshkrimit të bashkëpandehurit I.K. në cilësinë e kryetarit të KRRT-së, Peshkopi, edhe

nënshkrimin e kërkuarit në cilësinë e sekretarit të saj. Sipas akuzës, miratimi i këtyre lejeve është bërë në kundërshtim me ligjin e urbanistikës, ndaj kërkuari dhe i bashkëpunohuri I.K. kanë kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim. Gjatë hetimeve paraprake, kërkuari e ka kundërshtuar akuzën me argumentin se në kohën e miratimit të lejeve në fjalë ai nuk ka qenë në detyrën e përgjegjës të seksionit të urbanistikës, ndaj nuk mund të mbante përgjegjësi për veprimet e kryera për miratimin e tyre. Sipas tij, ai është emëruar në detyrë muajin në mars të vitit 2009 dhe në përputhje me ligjin e urbanistikës, në vijim, ka zbardhur ato leje, duke i nënshkruar në cilësinë e sekretarit të KRRT-së, Peshkopi, krahas nënshkrimit të kryetarit të këtij organi.

22. Edhe gjatë gjykimit, pavarësisht se ka kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar, kërkuari e ka kundërshtuar akuzën mbi të njëjtat argumente dhe fakte të pretenduara. Gjykata e shkallës së parë, në analizën e elementeve të veprës penale, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, për sa i përket anës objektive të saj, por edhe qenies së kërkuarit si subjekt i posaçëm i saj, ka pranuar si të provuar faktin se ai, në cilësinë e përgjegjës të zyrës së urbanistikës: (i) ka realizuar shqyrtimin administrativ të kërkesave dhe dokumentacionit për leje sheshi dhe ndërtimi të shtetasve Sh.K. e D.M. dhe në përfundim të këtij shqyrtimi, në kundërshtim ligjin e urbanistikës, ka vendosur dërgimin e tyre për miratim në KRRT-në, Peshkopi, e cila i ka miratuar me vendimin nr. 12, datë 29.09.2006; (ii) nuk ka ushtruar ose mbajtur akte kontrolli për çdo fazë të realizimit të punimeve të ndërtimit nga ana e shtetasve Sh.K. dhe D.M., ndërkohë që ndërtimi i realizuar nga ata ka devijime të gjendjes faktike në raport me planimetrinë e lejes së ndërtimit të miratuar, ku për pasojë janë cenuar hapësira publike. Nga ana tjetër, për sa i përket të bashkëpunohurit I.K., gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se nuk provohet të ketë kryer veprën penale që akuzohet bashkë me kërkuarin, ndërsa nënshkrimi nga ai i lejes së ndërtimit, në cilësinë e kryetarit të KRRT-së, Peshkopi është detyrim ligjor sipas ligjit të urbanistikës.

23. Edhe pse kërkuari i ka parashtruar të njëjtat pretendime në ankim, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi si kjo e fundit. Kurse në lidhje me rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se në të nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, duke e gjetur të pabazuar pretendimin për provueshmërinë e përgjegjësisë së tij penale përtej çdo dyshimi, me arsyetimin se në lidhje me fajësinë e tij gjykatat e faktit kanë konstatuar faktin se leja e ndërtimit e datës 29.09.2006 është nënshkruar nga ai në cilësinë e sekretarit të KRRT-së, Peshkopi.

24. Nën dritën e rrethanave të mësipërme, Gjykata vëren se fakti penal i njoftuar kërkuesit në rastin e ngritjes së akuzës ndaj tij lidhet me procedurat e ndjekura për shqyrtimin e kërkesave dhe, më tej, me miratimin në datën 29.09.2006 nga KRRT-ja, Peshkopi, të lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit në favor të shtetasve Sh.K. dhe D.M., si dhe me ushtrimin nga ai gjatë kësaj procedure të detyrës së përgjegjësitet të seksionit të urbanistikës së Bashkisë Peshkopi. Ndërkohë, fakti penal, mbi të cilin gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar përgjegjësinë penale të kërkuesit, ka përfshirë edhe mosushtrimin dhe mosmbajtjen nga ai, në cilësinë e përgjegjësitet të seksionit të urbanistikës, të akteve të kontrollit për çdo fazë të realizimit të punimeve të ndërtimit nga ana e shtetasve Sh.K. dhe D.M. Megjithatë, gjykatat e zakonshme nuk tregojnë në arsyetimin e tyre ndonjë provë konkrete të vlerësuar nga ato në lidhje me faktin e pranuar se shqyrtimi administrativ i kërkesave të shtetasve Sh.K. e D.M. për leje sheshi dhe leje ndërtimi, të miratuara në vijim, në datën 29.09.2006, nga KRRT-ja, Peshkopi, është bërë nga kërkuesi, në cilësinë e përgjegjësitet të seksionit të urbanistikës, sikundër as për faktin se ndërtimi i shtesës anësore nga ata shtetas është bërë gjatë kohës kur kërkuesi ka ushtruar detyrën në fjalë. Ato gjykata nuk arsyetojnë as në lidhje me ato prova të administruara rregullisht në gjykim, si pjesë e fashikullit të hetimit, që përmbajnë të dhëna të ndryshme në lidhje me faktet e pranuar si të provuara. Në veçanti, pavarësisht se ky ka qenë një nga pretendimet kryesore të kërkuesit, gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar, referuar provave konkrete, në drejtim të kohës kur ai ka ushtruar detyrën e përgjegjësitet të seksionit të urbanistikës, sikundër as për provën e kërkuar prej tij, pikërisht për vendimin nr. 40, datë 18.03.2009 të kryetarit të Bashkisë Peshkopi, për emërimin e kërkuesit në këtë detyrë.

25. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se përcaktimi i fakteve të rëndësishme për çështjen e kërkuesit nga gjykatat e zakonshme nuk duket i arsyeshëm, për sa kohë në vendimet e tyre mungon tërësisht arsyetimi në drejtim të vlerësimit të provave të administruara në gjykim, përfshirë edhe i provave të kundërta, çka është detyrim për gjykatën në kuptim të garantimit të parimit të barazisë së palëve në gjykim. Në këtë kuptim, në kontekst të rastit konkret, për sa kohë që gjetjet faktike të gjykatave nuk duken objektivisht të justifikueshme dhe të arsyeshme, edhe zbatimi i ligjit ndaj këtyre fakteve lë vend për dyshim se ka çuar në një vlerësim jo të drejtë të përgjegjësitet penale të kërkuesit. Në kuptim të parimit të prezumimit të pafajësisë, nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore të kundërshtuara nuk duket që gjykatat të kenë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për t'i mbështetur ato në prova të drejtpërdrejta ose të tërthorta të provuara nga akuza dhe që fajësia e kërkuesit të jetë provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Arsyetimi i gjykatave konsiderohet si haptazi i paarsyeshëm në këndvështrimin kushtetues, ndërsa mungojnë arsyet bindëse për deklarinin fajtor të

kërkuesit, duke sjellë për të cenimin e së drejtës për t'u prezumuar i pafajshëm derisa fajësia të jetë provuar ligjërisht dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

26. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor janë të bazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

27. Ndërkohë, duke mbajtur në vëmendje se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur shqyrtohen ankesa individuale kushtetuese, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit, Gjykata vlerëson se specifikat e çështjes konkrete dhe natyra e pretendimit të kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë kërkojnë vlerësim nga gjykatat e zakonshme të faktit në drejtim të përcaktimit të fakteve në raport me përgjegjësinë e tij penale. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se çështja e kërkuesit duhet të dërgohet për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së dytë, konkretisht në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në përputhje me kompetencën e saj lëndore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 1766, datë 03.07.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2023-1445, datë 19.09.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vetëm për sa i përket kërkuesit Dritan Nuzi, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.10.2024

Shpallur më 13.11.2024